



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKI I KOSOVOVA
 KESHILLI I PROKURORISE - TUZILACI SAVETI KOSOVA
 SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
 ARKIVA - ARHIVA

Pranuar 01-08-2022 Primitjeno

Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nënshkrimi i pranuesit Potpis primaoca
1276		



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

MEKANIZMI I RAPORTIMIT TË KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE THEMELORE NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

I. PJESA E PËRGJITHSHME:

Emri, mbiemri Kryeprokurorit		Prokuroria		Periudha raportimit		Nënshkrimi													
Numri i prokurorëve dhe stafit administrativ në prokurori:		Kryeprokurori:		1		Administratori:													
		Nr. i prokurorëve në DKR:		13		Bashkëpunëtorë profesional:													
		Nr. i prokurorëve në DM:		7		Zyrtar ligjor:													
		Nr. i prokurorëve në DP:		22		Stafi tjetër:													
		Totali:		43		Totali:													
A) Numri i kallëzimeve penale të pranuar:		B) Numri i kallëzimeve penale të proceduara (zgjidhura/kryera):		C) Përqindja e rasteve të proceduara (B%A)		D) Ngarkesa me lëndë													
4.655		2.616		56.19%		49.697													
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga prokurori:		Aktakuza të ngritura:		Hudhje të kallëzimit penal:		Pushim i hetimeve:													
		1.698		255		216													
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata:		Aktakuza të hudhura:		Aktakuza të refuzuara		Aktgjykime liruese													
		639 (parashkrim)		23		5													
Ankesa kundër aktgjykimit gjithsej 38				Ankesa kundër aktvendimit															
Të aprovuara		Të refuzuara		Të aprovuara		Të refuzuara													
4		13		8		7													
Arritshmëria e normës orientuese të prokurorëve, për periudhën kohore të raportimit:																			
Departamenti për Krime të Rënda:				% 6 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,															
Departamenti për të Mitur:				% 10 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,															
Departamenti i Përgjithshëm:				% 23 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,															
Arritshmëria e normës në Prokurori:				% Mesatarja (3/1) e përqindjet në prokurori															
Performanca e prokurorisë në luftimin e Korrupsionit (Paditë Penale 'PP'). Shëno të dhënat në tabelë:																			
Raste të pranuar:		Raste të kryera:		Ngarkesa me raste:		Hudhje		Pushim		Janë ngritur Aktakuza		Aktakuza hudhura		Aktakuza të refuzuara		Aktgjyqi me liruese		Aktgjykimi dënues	
R ¹ P ²		R P		R P		Persona		Persona		Persona		Persona		Persona		Persona		Persona	
32 62		21 120		83 194		15		96		5				1		3		2	

¹ R¹-nëkupton rastet (kallëzimet penale)

² P² - nëkupton personat në kallëzime penale

Performanca në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Shëno të dhënat në tabelë:				
Kërkesa të aprovuara për dhënin e urdhrat për sekuestrim të përkohshëm	Kërkesa të aprovuara për konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve financiare	Kërkesa të aprovuara për dhënin e asetëve në shfrytëzim të qeverisë	Kërkesa të aprovuara për dhënin e asetëve në administrim të AAPSK	Kërkesa për kompenzimin e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara

II. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

1	<p>Niveli i organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë?</p> <p>Komento:</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, prill- qershor të vitit 2022, organizimi, menaxhimi, administrimi dhe funksionimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka qenë në brenda parametrave të përcaktuara.</p> <p>Zyra e Kryeprokurorit të PTH në Prishtinë ka funksionuar çdo ditë me orar të plotë të punës. Kryeprokurori ka organizuar dhe mbajtur kolegji me të rregullta (periodike) me prokurorët e departamenteve të ndryshme. Përveç kësaj, ai ka qenë i gatshëm gjithmonë që të presë në konsultime prokurorët dhe hetuesit dhe të bashkëpunojë me ta për raste më të ndërlikuara. Përveç kësaj, kujdestarët në të gjitha departamentet kanë funksionuar në nivel shumë të mirë dhe reagimi i prokurorëve kujdestarë, përgjithësisht ka qenë i shpejtë dhe efektiv në trajtimin e rasteve të paraqitura.</p> <p>Po ashtu referuar dispozitës të nenit 156 të KPPRK-së, Kryeprokurori, ka zbatuar këtë dispozitë ligjore duke trajtuar analizuar rastet për të cilat ka filluar hetimi penal.</p> <p>Nga prokurorët kujdestarë është kërkuar raport me shkrim lidhur me mbarëvajtjen e kujdestarisë në mënyrë që të vazhdohet kronologjia e rasteve me hetuesit kompetent të rasteve si dhe të mbajnë të informuar Udhëheqësin e Departamentit përkatës, si gjatë kujdestarisë edhe pas çdo përfundimit të kujdestarisë. Të njëjtëve vazhdimisht iu është ofruar mbështetje si nga kryeprokurori ashtu edhe nga udhëheqësit.</p> <p>Në përgjithësi, mbarëvajtja e procesit të punës ka qenë e suksesshme.</p> <p>Më tej, mund të gjeni të dhënat rreth organizimit të PTH në Prishtinë.</p> <p>PTH në Prishtinë është prokuroria më e madhe në Republikën e Kosovës. Kjo prokurori ka afro 60% të lëndëve në nivel të vendit dhe mbulon 34% të territorit të Republikës së Kosovës.</p> <p>Struktura organizative e PTH në Prishtinë është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryeprokurori, si udhëheqësi më i lartë i institucionit, - Departamenti i Krimeve të Rënda - katërbëdhjetë (14) prokurorë, - Departamenti për të Mitur - shtatë (7) prokurorë, - Departamenti i Përgjithshëm - njëzet e pesë (25) prokurorë, si dhe gjatë periudhës raportuese është dekretuar një prokuror i ri. <p>Po ashtu, në kuadër të Prokurorisë janë themeluar dy njësite të veçanta, të cilat trajtojnë lëndë të natyrës më specifike, dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion; - Njësi për trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje; <p>Përveç kësaj, janë caktuar prokurorët si koordinatorë për vepra penale të caktuara, ashtu që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Koordinator për rastet e Dhunës në familje</i> është caktuar prokurorja Shenaj Berisha,
---	---

2. *Koordinator për veprat penale të Narkotikëve* është caktuar prokurori Besnik Jakupi,
3. *Koordinator për procedurën e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtarë* nga Departamenti i Krimeve të Rënda është caktuar prokurori Armend Hamiti ndërsa nga Departamenti i Përgjithshëm është caktuar prokurori Blerim Igrishta,
4. *Koordinator për veprat penale të Trafikimit me Qenie Njerëzore* është caktuar prokurori Ilaz Beqiri,
5. *Koordinator për procedurën e Sekuestrimit dhe Konfiskimit* nga radhët e Departamentit të Përgjithshëm është caktuar prokurori Bekim Kodraliu, nga radhët e Departamentit të Krimeve të Rënda është caktuar prokurori Bashkim Zeqaj.
6. *Koordinator për rastet e krimeve kibernetike*, është caktuar prokurori Arianit Salihu.
7. *Prokurore kontaktuese për rastet e piraterisë* është caktuar prokuroreja Elza Bajrani.

Mbështetur në Rregulloren për organizimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit, Administrata ka këtë strukturë organizative:

- Administratori/ja;
- Udhëheqësi i Sektorit të Shkrimore;
- Bashkëpunëtorët profesional;
- Zyrtarët ligjorë;
- Sekretarët juridikë;
- Referentët;
- Arkivistët;
- Përkthyesit;
- Fletëdorëzuesit;
- Receptionsistët;
- Vozitësit;

2	<p>Çështjet e avancimit dhe transferimit të prokurorëve? Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi pasur avancim dhe transferim të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Prishtinë .</p>
3	<p>Çështjet e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve apo stafit mbështetës? Komento:</p> <p>Gjatë periudhës Prill- Qershor të vitit 2022, kemi pranuar nga tre (3) raste</p> <p>Prej tyre dy (2) janë parashtruar nga palët dhe 1 është hapur sipas detyrës zyrtare. dhe atë:</p> <p>AD.nr. 05/2022, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.26.04.2022 është marrë Vendim për refuzim, të ankesës.</p> <p>AD.nr. 06/2022, rast i iniciuar sipas detyrës zyrtare,</p> <p>AD.nr. 07/2022, rast i iniciuar nga pala.</p> <p>Rastet e trashëguara nga viti 2021:</p> <p>AD.23/21, është marr Vendim për Hudhje të ankesës</p>

	<p>Ndërsa sa i përket stafit mbështetës</p> <p>Në periudhën raportuese, janë shqiptuar tre (3) masa disiplinore Vërejtje me shkrim, për staf administrativ.</p>
4	<p>Çështjet e vlerësimit të punës së prokurorëve përfshirë mospajtimet e prokurorëve? Nivelet e vlerësimit të prokurorëve si dhe tejkalimi kuotës 20% të dalluar?</p> <p>Komento:</p> <p>Meqenëse ne këtë periudhe prill-qershor sipas rregullores 05/20, kemi diskutimin 6 muhor për prokurorë, e që në këtë vlerësim gjashtëmuhor <u>janë cekur vetëm shqetësimet e eprorit lidhur me mangësitë si dhe Këshillat specifike të Eprorit dhe masat propozuara për përmirësim e prokurorit, andaj është bërë një vlerësim të përgjithshëm i prokuroreve ne Prokurorin Themelore në Prishtinë .</u></p> <p>Shqetësim i përgjithshëm që ndërlidhet me të gjithë prokurorët e të cilëve u janë dhënë rekomandime janë: Përpilimi i Akteve Akuzuese, të analizohen dhe shtjellohen të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës</p> <p>Që në aktin akuzues të ceket e kaluara kriminale e të pandehurit (recidivizmi), veçanërisht nëse bëhet fjalë për kryerjen e të njëjtës vepër penale. Recidivizmi i shumëfishtë për të njëjtën vepër penale është indikator i fuqishëm për gjykatën që të shqiptojë maksimumin e dënimit;</p> <p>Që gjatë përpilimit të aktakuzave kujdes i veçantë të i kushtohet evitimit të gabimeve teknike , strukturës të aktit akuzues në mënyrë që e njëjta ti përmbaj elementet e përcaktuara konform Legjislacionit në fuqi</p> <p>Këshillohet që çdo muaj të bëhet plani i veprimit për lëndët që do të trajtohen me prioritet në muajin pasues. Kësisoj, do të ketë një pasqyrë më të saktë rreth statusit të lëndëve dhe domosdoshmërisë për të marrë veprime.</p>
5	<p>Çështjet e rasteve të ndërlikuara dhe vendimet nga Kryeprokurori për njohjen e këtyre rasteve ?</p> <p>Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudha raportuese nuk kemi pasur ndonjë rast të referuar nga ana e prokuroreve që i njëjti sipas Udhëzimit Administrativ nr.01/2018, për caktimin e normës orientuese për prokurorët e shtetit, të përcaktohet si rast i ndërlikuar.</p> <p>Rastet e zgjidhura për gjatë kësaj periudhe ndërlikuara janë:</p> <p>Rasti i zgjidhur i evidentuar me nr.PP.I.29K.18, ku subjekt në këtë lëndë kanë qenë 90 të dyshuar- doktor përkatësisht lëndë e ndërlikuar e pranuar nga Prokuroria Speciale e Republikës e Kosovës.</p>

	<p>Megjithatë, duhet cekur se ka raste aktive të ndërlikuara përgjatë kësaj periudhe, të cilat janë duke u trajtuar nga prokurorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rasti që ka të bëjë me Mariah Thoraya Bamieh, - Rasti që ka të bëjë me Postën, - Rasti që ka të bëjë me MASHT-in - Rasti që ka të bëjë me rekrutimin e punëtore në KEK-
6	<p>Ankesat ndaj shqiptimit të sanksionit penal të shqiptuar (<i>Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit</i>) ?</p> <p>Komento:</p> <p>Nga praktika e përcjellë për rastet penale të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, është vërejtur se gjykata aplikon dënim më të ulët duke mos përfshirë rrethanat rënduese dhe se nuk ka praktikë të unifikuar lidhur me rastet e njëjta. Kjo situatë vlen edhe për rastet e natyrës së korrupsionit, ku politika ndëshkimore për rastet në aktgjykimet e korrupsionit të dënuarit në përgjithësi iu shqiptohen dënime me kusht, përkundër natyrës dhe peshës të veprës penale e një rëndësie të veçantë shtetërore e po ashtu si dhe nga raportet Evropiane si dhe ato Ndërkombëtare ku të njëjtat në raportet e tyre kanë konstatuar se kemi mungesë të dënimeve efikase me rastin e shqiptimit të sanksioneve të këtyre veprave penale.</p> <p>Për të vënë në zbatueshmëri Udhëzimin e Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit, Kryeprokurori i PTH në Prishtinë është vazhdimisht vigjilent ndaj aktgjyqimeve, veçanërisht të lëndëve që bien në domenin e Departamentit për Krime të Rënda. Kryeprokurori i ka udhëzuar prokurorët e rasteve/përfaqësues që të ushtrojnë ankesë, çdo herë që sanksionet penale të shqiptuara nuk janë adekuate apo të mjaftueshme. Në kolegjiunet e mbajtura me prokurorët e të gjitha departamenteve, Kryeprokurori ka qenë i zëshëm për të adresuar problematikën e politikës ndëshkimore të gjykatës, ashtu që, që në kolegjiunin e parë të mbajtur në muajin janar, moszbatimi i Udhëzuesit për politikë ndëshkimore i Gjykatës Supreme ka qenë pikë e rendit të ditës. Kryeprokurori i ka tërhequr vërejtjen të gjithë prokurorëve që të analizojnë aktgjykimet dhe dënimet me kujdes dhe të vlerësojnë mundësinë për të paraqitur ankesë.</p> <p>Sa i përket Udhëzimit të Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit, i njëjti është pranuar fizikisht nga prokurorët e PTH në Prishtinë gjatë muajit prill –qershor të vitit 2022. Prokurorët janë udhëzuar që ta lexojnë dhe analizojnë me kujdes përmbajtjen e këtij udhëzimi dhe ta zbatojnë përpikmërisht sa herë që paraqitet e nevojshme për të ushtruar ankesë ndaj sanksionit penal të shqiptuar.</p>
7	<p>Zbatimi i politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit? Cilat janë kriteret e përzgjes së prokurorëve mentorë për prokurorët fillestar?</p> <p>Komento:</p> <p><u>Në këtë periudhë raportuese prokurorët janë angazhuar në pjesëmarrje në trajnime dhe atë:</u></p> <p>Me dt. 19.05.2022, është mbajtur trajnimi "Trajnim për Institucionet Ligjzbatuese lidhur me veprat penale kundër Katshëve" në të cilin kanë marrë pjesë 2 prokurorë nga DP dhe Njësi i Dhunës në Familje,</p> <p>Me dt. 19-20.05.2022, është mbajtur trajnimi "Liria e shprehjes dhe Liria e mediave" në të cilin kanë marrë pjesë 4 prokurorë nga DP,</p> <p>Me dt. 23-26.05.2022, është mbajtur trajnimi "Hetimin financiar dhe gjurmimin e pasurive të paligjshme" në të cilin kanë marrë pjesë 3 prokurorë nga Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion,</p>

	<p>Me dt. 17-20.05.2022, është mbajtur trajnimi “Konfiskimi dhe Sekuestrimi” në të cilin kanë marrë pjesë 2 prokurorë nga Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion dhe DP,</p> <p>Me dt. 25.05.2022, është mbajtur trajnimi “Punëtori për përmirësimin e qasjes në dokumente publike” në të cilin kanë marrë pjesë 2 prokurorë nga DP,</p> <p>Me dt. 23-24.05.2022, është mbajtur trajnimi “Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim” në të cilin kanë marrë pjesë 6 prokurorë nga DP,</p> <p>Me dt. 31.05.2022, është mbajtur puntoria “Identifikimi dhe trajtimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore” në të cilin kanë marrë pjesë 2 prokurorë nga DKR</p> <p>Në datat 15-17 qershor 2022, në Bordo të Francës u zhvillua Takimi i 58-të Plenar i Rrjetit Gjyqësor Evropian (EJN), i mbajtur nën Presidencën Franceze të Këshillit të BE-së.</p> <p>Qëllimi i një mbledhjeje plenare është për të lejuar pikat e kontaktit të njihen me njëri-tjetrin dhe të ndajnë përvojën, veçanërisht në lidhje me funksionimin e rrjetit dhe për të siguruar një forum për diskutimin e problemeve praktike dhe ligjore të hasura nga shtetet anëtare në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale.</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, si prokuror mentor për Prokurorin e Shtetit Lulzim Aliu, është caktuar Prokurori Arianit Salihu. Si kriteret të përzgjedhjes së prokurorëve mentorë, janë: përvoja, profesionalizmi, etika dhe integriteti personal dhe aftësia për bashkëpunim kolegjial.</p>
8	<p>Niveli i zbatimit të Kodit të Etikës profesionale për prokurorë dhe stafin administrativ? Komento:</p> <p>Në Prokurorinë Themelore në Prishtinë prokurorët i respektojnë të gjitha standartet e sjelljes konform Kodit të Etikës, si brenda ashtu edhe jashtë zyrës dhe kjo reflektohet pozitivisht në veprimtarinë e tyre profesionale. Përrjashtimisht, për prokurorët të cilët ka pasur pretendime se nuk e kanë respektuar</p> <p><u>Sa i përket moszbatimit të Kodit të Etikës</u> në Prokurorinë Themelore në Prishtinë ekziston dosje individuale për secilin prokuror ku deponohen shënime rreth veprimeve të tyre, e të cilat mund të kenë rol në vlerësimin e performancës vjetore.</p> <p>Sa i përket stafit mbështetës gjatë periudhës raportuese, në përgjithësi niveli i zbatimit të Kodit të Etikës Profesionale ka qenë i kënaqshëm.</p>
9	<p>Niveli i pavarësisë së prokurorëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshume gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale? Komento:</p> <p>Për periudhën raportuese, prokurorët e PTH në Prishtinë e kanë kryer funksionin e tyre në mënyrë të pavarur, në bazë të vlerësimit të saktë të fakteve dhe në përputhje me Kushtetutën, si dhe në zbatim të</p>

drejtë të ligjit, duke mos u ndikuar nga brenda dhe jashtë. Kryeprokurori vazhdimisht u ka tërhequr vëmendjen prokurorëve që të shmangin çdo përpjekje të parregullt dhe të paligjshme, e cila mund të ndikojë në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre.

10 Zbatimi i politikave të KPK dhe ZKPSH, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ?

Komento:

Përgjatë periudhës së raportimit, një theks i veçantë i është dhënë ndjekjes penale të veprave karakteristike. Në kolegjiunet e mbajtura, shpeshherë këto vepra penale kanë qenë temë diskutimi dhe prokurorët janë udhëzuar që t'i trajtojnë me prioritet këto kategori të lëndëve.

Sa i përket regjistrit të lëndëve me kryerës të njohur PP, në PTH në Prishtinë, janë të dhënat si në vijim:

Armët - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 14 raste të pazgjidhura. Për këtë kategori të veprave penale, rëndësi i është dhënë caktimit të kompetencës së rasteve ndërmjet Departamentit të Përgjithshëm dhe Departamentit për Krime të Rënda.

Drogat - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 711 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 90 lëndë. Për herë të parë, për këtë kategori të veprave penale, një (1) prokuror është caktuar koordinator. Koordinatori përcjellë çështjet penale lidhur me narkotikët, mban evidencë për numrin e rasteve, mbështet prokurorët tjerë më këshilla sipas nevojës, njofton sipas kërkesës Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit lidhur më këto raste, si dhe merr pjesë në takime, seminare apo trajnime lidhur me këto raste, duke respektuar udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit. Koordinatori po ashtu do të ofrojë bashkëpunim dhe koordinim me mekanizma ndërinstitucionalë dhe ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së efikasitetit në luftimin e narko-kriminalitetit dhe ndjekjes së kryerësve të këtyre veprave penale. Sipas nevojës, Koordinatori do t'i ofrojë bashkëpunim Koordinatorit Nacional kundër Narkotikëve.

Korrupsioni - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 136 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 24 lëndë.

Krimet ekonomike - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 160 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 5 lëndë.

Trafikimi me njerëz - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 9 raste të pazgjidhura, ndërsa është zgjidhur 3 lëndë. Për këtë kategori të veprave penale, një (1) prokuror është caktuar koordinator. Koordinatori për rastet e trafikimit me qenieve njerëzore përcjell rastet e trafikimit më njerëz, mban evidencë për numrin e rasteve, mbështet prokurorët tjerë më këshilla sipas nevojës, njofton sipas kërkesës Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit lidhur më këto raste, si dhe merr pjesë në takime, seminare apo trajnime lidhur më këto raste, duke respektuar udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit.

Kontrabandimi me migrant - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 27 raste të pazgjidhura.

Nxifja e urrejtjes - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 3 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 2 raste.

Sa i përket regjistrit të lëndëve me kryerës të njohur PPN, në PTH në Prishtinë, janë të dhënat si në vijim:

Drogat - në fund të periudhës raportuese, gjithsej ka mbetur 2 raste të pazgjidhur.

Korrupsioni - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 390 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 83 lëndë.

Krimet ekonomike - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 87 raste të pazgjidhura.

	<p><u>Trafikimi me njerëz</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej ka mbetur 0 rast i pazgjidhur.</p> <p><u>Kontrabandimi me migrant</u> - në fund të periudhës raportuese, është zgjidhur 0 rast.</p>
11	<p>Niveli i zbatimit të kërkesave nga Komisionet e Përhershme të Këshillit dhe nga vet KPK-ja?</p> <p>Komento:</p> <p>Sa i përket Komisioneve të Përhershme të Këshillit, është pranuar një kërkesë. E cila është pranuar në tremujorin e parë e cila është raportuar ndërsa kërkesa për fillin e procedurës disiplinore është iniciuar me dt.04.04.2022, sipas kompetencës së Autoritetit Kompetent</p> <p>Të gjitha kërkesat e adresuara nga KPK-ja janë zbatuar përpikërisht dhe brenda afateve.</p>
12	<p>Performanca e prokurorëve në përdorimin e sistemit SMIL ?</p> <p>Komento:</p> <p>Pothuajse të gjithë prokurorët e PTH në Prishtinë janë trajnuar në përdorimin e sistemit SMIL nga trajnerët përkatës. Përdorimi i sistemit është në nivele të mjaftueshme. Si sfidë kryesore mbetet përdorimi i sistemit SMIL gjatë kujdestarive, për shkak të vonesave në pranimin e shkresave nga policia dhe përcjelljen e tyre në gjykatë përmes sistemit. Veçanërisht, kjo pengesë shfaqet gjatë ditëve të kujdestarisë të cilat bien gjatë vikendit apo festave zyrtare, për shkak të mungesës së stafit administrativ për të regjistruar dhe procesuar shkresat përmes sistemit.</p> <p>Edhe pse prokurorët përgjithësisht kanë nivel të mjaftueshëm të njohurive rreth sistemit SMIL, një pjesë e tyre vazhdimisht ndihmohen nga stafi mbështetës, të cilët janë trajnuar plotësisht në përdorimin efektiv të këtij sistemi.</p> <p>Nga vlerësimi i përgjithshëm rreth përdorimit të sistemit SMIL, kemi verifikuar edhe nivelin e përdorimit të projektit SMIL nga vet prokurorët. Vlerësimi i prokurorëve është bërë duke i vlerësuar nga numri 1-10, andaj bazuar në këtë vlerësim edhe sot kemi këtë gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 20 prokurorë që përdorin sistemin SMIL në mënyrë të avancuar; - 6 prokurorë që janë përdorues të SMIL mbi mesataren, - 16 prokurorë janë përdorues të SMIL me nivel nën mesataren, si dhe të tjerët kanë nevojë ende për asistencë shtesë. <p>Prokurorët që sot nuk e përdorin mjaftueshëm këtë sistem, kemi konstatuar se problemi kyç që mund të jetë pengesë është mosha, e që si pasojë e kësaj edhe aftësitë të tyre që të jenë përdorues të mirë të këtij sistemi është pak e vështirë, andaj edhe sot të njëjtit marrin ndihmë nga zyrtarët e sistemit SMIL-it.</p>
	<p>Sfidat apo të arriturat:</p> <p>Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese një ndër sfidat kryesore me të cilën përballën në vazhdimësi stafi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë është çështja e klimatizimit të objektit, e cila ndikon negativisht në</p>

procesin e punës , kjo për shkak se është e pamundur të punohet pa ndërprerje të herë pas hareshme të punës për shkak të temperaturave të larta në zyre.
Sfidë tjetër është paraqitur situata e krijuar me Covid, ku si pasojë një numër i madhe i stafit kanë rezultuar pozitiv, gjë që ka penguar në përgjithësi procesin e rregullt të punës.

Sa i përket të arriturave Kryeprokurori i Pth-së, në vazhdimësi zhvillon takime me Përfaqësues të Institucioneve vendore dhe Ndërkombëtare me qëllim të rritjes të bashkëpunimit dhe luftimit të Krimit , ku ndër të tjerash ja vlen të ceket Bashkëpunimi që është arritur për herë të parë në mes të PTH-së dhe Komisionit për hetimin e aksidenteve hekurudhore dhe aeronautike në kuadër të Zyrës Kryeministrit, e i cili bashkëpunim është shumë i nevojshëm sidomos gjatë kësaj periudhe raportimi duke pasur parasysh edhe numrin e madhe të fluturimeve që kryhen nga Aeroporti i Prishtinës .

III. ZBATIMI I OBLIGIMEVE SIPAS PLANIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË SHITETIT

1	<p>Objekti 1: Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale me prioritet. Komento:</p> <p>Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, mban takime të rregullta në baza mujore dhe ditore me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Hetuesisë, Inspektoratit Policor, si dhe akter ndërkombëtar me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe diskutimit për rritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kryeprokurori ka mbajtur takime edhe me hetuesit e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve Hekurudhore dhe Aeronautike, me qëllim të trajtimit sa më efikas edhe të këtyre rasteve, ku ndër të tjerash është vendosur që të caktohet një prokuror si pikë kontakti për këto raste e i cili do të dërgohet edhe në trajnime brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të profilizohet për rastet në fjalë.</p> <p>Kryeprokurori çdo dy javë mban kolegji me prokurorët e dep. Përgjithshëm dhe me prokurorët e dep. Krime të Rënda dhe dep. për të Mitur, po ashtu vazhdimisht kërkon nga të gjithë që këtë vit të punojnë edhe më shumë, në mënyrë që të tregojmë efikasitet, të rrisim besimin e publikut, të bashkëpunojnë së bashku, e nëse duhet ndihmë të formohen grupe punuese në mënyrë që lëndët të trajtohen me kohë dhe në mënyrë sa më profesionale.</p> <p>Për nevoja të forcimit të departamentit të Krimeve të Rënda dhe Njësitit kemi kërkuar të shtohet numri i prokurorëve në këto departamente.</p> <p>Nga veprimet e lartcekura është shënuar një progres në trajtimin e lëndëve aktive brenda prokurorisë.</p>
2	<p>Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit. Komento:</p> <p>Përgjatë kësaj periudhe, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka hartuar në baza ditore raportin 24 orësh në kohë të paraparë dhe i është dërguar Zyrës për Informim në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.</p> <p>Raporti 24 orësh ka sjellë rezultat të shkëlqyeshëm në përmirësimin e komunikimit të brendshëm në Prokurorinë Themelore-Prishtinë, duke kontribuar në procesin e punës si element pozitiv, e po ashtu edhe në komunikimin e jashtëm, përmes publikimit të këtij raporti kemi arritur t'i servojme publikut informata lidhur me veprimtarinë 24 orëshe të PThP-së dhe jo vetëm për opinionin publik, mediat online kanë prodhuar shkrime (lajme) për aktakuzat e ngritura çdo 24 orësh, me theks aktakuzat e ngritura për rastet e dhunës në familje dhe ato të natyrës korruptive.</p>

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2022, prokuroria jonë ka hartuar dhe lëshuar për media gjithsej 18 komunikata/njoftime/sqarime, përfshirë edhe aktivitetet (takimet) ku prej tyre kanë qenë katër (4). Po ashtu, vlen të ceket se gjatë këtij tremujori, Zyra për Informim e Prokurorisë Themelore Prishtinë (zëdhënësja) ka dhënë 17 prononcime për Televizionet vendore, lidhur me çështje të ndryshme penale, si dhe, ka pranuar gjithsej 146 pyetje dhe ka dhënë 136 përgjigje.

Temat të cilat janë publikuar përmes këtyre komunikatave i gjeni si në vijim:

1.) Diskutohet Projekti i BE-së me Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 5 prill 2022- Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, i shoqëruar nga përgjegjësja e Departamentit të Përgjithshëm, Jehona Grantolli, kanë pritur në takim ekspertë të projektit të BE-së, Laurence Hanvey Key dhe Brian Robinson. Ky projekt është i implementuar nga NICO (Northern Ireland Cooperation Overseas), me temën "Mbështetje Reformës në Policinë e Kosovës".

Takimi kishte për qëllim njohjen e pjesëmarrësve me legjislacionin vendor, aplikimin e masave të fshehta në rastet penale, konkretisht masën e përgjimit ligjor, bashkëpunimi ndërinstitucional prokurori-polici, aplikimi i nenit 70 të KPPK-së, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, respektivisht neni 2 e neni 6 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, aplikimi i procedurave standarde të operimit me theks të veçantë tek mbrojtja e të drejtave të njeriut, etj.

2.) NJOFTIM NGA PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

Prishtinë, 5 prill 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Krimeve të Rënda, konkretisht Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, pas raportimeve të publikuara në disa portale lidhur me pretendimet se janë kryer shkelje të rënda ligjore në procesin e rekrutimit të qindra personave në një konkurs të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), më 04.04.2022, ka iniciuar hetime, ashtu që do të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, me qëllim të sqarimit të plotë të këtyre pretendimeve, konform dispozitave ligjore në fuqi.

3.) Aktakuzë kundër tre personave për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar

Prishtinë, 20 prill 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve F.H., L.J. dhe Y.K., në drejtim të veprës penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", nga neni 414 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, më 22.12.2020, të pandehurit, në cilësinë e personave zyrtarë (IT), në QKUK, në bashkëkryerje dhe në kundërshtim me Ligjin me Nr.04/L-042, për Prokurimin Publik, kanë shfrytëzuar detyrën zyrtare, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo tjetrin, duke mos i përmbushur detyrat e tyre zyrtare, në atë mënyrë që në aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi i Sistemit të integruar të monitorimit me kamera dhe Integrimi i sistemit të kontrollit të qasjes", kontratë e nënshkruar në mes të QKUK dhe operatorit ekonomik "Artech", tërë aktivitetin e kryer në dhjetor të vitit 2020, përfshirë pranimin e mallit, ekzekutimin e punimeve dhe pranimin teknik të punimeve, kanë nënshkruar një raport fiktiv e që ka qenë në kundërshtim me gjendjen faktike, kështu duke i shkaktuar dëm material në shumën prej 104,751.00 €, QKUK-së.

4.) Reagim nga Prokuroria Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 25 prill 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, me qëllim të informimit të drejtë të opinionit publik, reagon lidhur me shkrimin e publikuar në portalin "Gazeta Sinjali", me titull "Ndodh edhe kjo/Denoncohet për dhunë në familje, Policia i gjen armë e municion, Prokurori e liron", duke ju

njoftuar se fillimisht prokurorja kujdestare nga Departamenti i Përgjithshëm është njoftuar nga policia lidhur me një rast të dhunës në familje, ashtu që me aktvendim mbi ndalim personi i dyshuar është ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Dhuna në familje", të paraparë sipas KPRK-së.

5.) Dy aktakuza kundër pesë personave për lëndim të lehtë trupor e kanosje ndaj dy gazetarëve

Prishtinë, 4 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit L.K., pasi i njëjti, më 28.09.2020, në Veternik, konkretisht në pompën e derivateve "Shell", pas një fjalosje me të dëmtuarin-gazetarin F.Ç., lidhur me një hulumtim për licencën e kompanisë, i pandehuri me dashje që t'i shkaktojë lëndime trupore të dëmtuarit e ka sulmuar fizikisht, me çka i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, andaj aktakuza është proceduar në gjykatën kompetente për trajtim të mëtejme, në drejtim të veprës penale "Lëndimi i lehtë trupor", nga neni 185 të KPRK-së.

Ndërsa, sipas aktakuzës së dytë, të pandehurit B.H., K.R., A.G. dhe A.H., më 14.12.2021, e kanë kanosur seriozisht të dëmtuarin-gazetarin V.K., përmes komenteve të ndryshme në rrjetet sociale, me këtë të pandehurit veç e veç kanë kryer veprën penale "Kanosja", nga neni 181 të KPRK-së.

6.) Kërkohet paraburgim ndaj personit i cili u gjet me narkotikë në afërsi të një shkolle

Prishtinë, 6 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, konkretisht Departamenti i Krimeve të Rënda, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndaj të pandehurit B.G., në drejtim të veprave penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", nga neni 267 dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Personi i lartcekur, më 05.05.2022, fillimisht është arrestuar nga policia në afërsi të shkollës "Gjergj Fishta", në Prishtinë, me ç' rast të njëjtit i është gjetur një sasi e vogël substancë narkotike e llojit marihuanë, dymijetreqindnjëzet (2320) euro dhe një thikë. Me kërkesë të Prokurorit të Shtetit dhe aprovim nga gjyqtari i procedurës paraprake, është bastisur shtëpia e të dyshuarit, ku janë gjetur dhe sekuestruar: dyzetetelë (48) qese të vogla me 39 gram substancë narkotike e llojit marihuanë, një (1) peshore digjitale, një (1) armëAK47 me një karikator dhe 50 fishekë dhe një (1) revole me një karikator dhe 8 fishekë.

7.) Ndalohet një person për vrasje të rëndë

Prishtinë, 8 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se më 07.05.2022, prokurorja kujdestare nga Departamenti i Krimeve të Rënda, është njoftuar nga policia për të shtëna me armë zjarri në fshatin Gushtericë të Graçanicës. E njëjta i është përgjigjur vendit të ngjarjes me njësitë e tjera relevante, ku në vendin e ngjarjes ekipi mjekësor ka konstatuar se një person ka mibetur pa shenja jete, si pasojë e plagëve të marra nga të shtënat me armë zjarri.

Me urdhër të prokurores është ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh personi me inicialet M.Sh., (zyrtar policor), në drejtim të veprës penale "Vrasja e rëndë", nga neni 173 të KPRK-së, pasi dyshohet se i njëjti ka privuar nga jeta tani të ndjerin D.Sh., (vëllain e tij), ndërsa trupi i pa jetë është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore, për obduksion.

8.) Aktakuzë kundër dy personave për vrasjen e rëndë në fshatin Gradicë të Drenasit

Prishtinë, 10 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Xh.B. dhe A.B., në drejtim të veprave penale "Vrasja e rëndë", nga neni 173 dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

9.) Ndalohet një person për lëshim të çqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorim të kartelave të bankës apo të kreditit

Prishtinë, 17 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se pas pranimit të informacionit nga Sektori për Hetimin e Krimeve Kibernetike të Policisë së Kosovës, me dyshimin se është kryer vepra penale "Lëshimi i çqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit", prokurori kujdestar nga Departamenti i Përgjithshëm, ka iniciuar rastin në drejtim të veprës penale të lartcekur, ku pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore dhe sigurimit të provave, fillimisht policia ka arrestuar të dyshuarin A.S., në vendin e tij të punës dhe me urdhër të Prokurorit të Shtetit, i njëjti është ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh, për shkak të veprës penale "Lëshimi i çqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit", nga neni 301 të KPRK-së, pasi i njëjti dyshohet se në mënyrë të kundërligjshme, duke keqpërdorur pozitën dhe besimin e klientëve, dyshohet se ka vjedhur të dhënat e kartelave bankare të klientëve, të cilët kanë bërë blerje në dyqanin ku i dyshuari ka punuar si përgjegjës i ndërrimit, dhe pastaj këto të dhëna i njëjti i ka përdorur duke bërë blerje të monedhave - kriptovalutave, të cilat më pas i ka shitur dhe me këtë rast dyshohet se ka përfutur mjete-para në vlerë prej mbi 5,000.00 €.

10.) Kërkohet paraburgim ndaj personit i cili keqpërdori të dhënat e kartelave bankare të klientëve

Prishtinë, 18 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Përgjithshëm, më 17 maj 2022, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente, ndaj të pandehurit A.S., në drejtim të veprës penale "Lëshimi i çqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit", nga neni 301 të KPRK-së. Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, në vazhdimësi e deri me datën 16.05.2022, në Podujevë, në cilësinë e personit përgjegjës të ndërrimit në një subjekt afarist, me qëllim që vetit apo ndonjë personi tjetër të i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka keqpërdorur pozitën dhe besimin e klientëve, respektivisht të një numri të konsiderueshëm të të dëmtuarve, duke ua vjedhur dhe fotografuar të dhënat e kartelave bankare të cilët kanë bërë blerje në këtë dyqan, ku këto të dhëna i ka përdorur duke bërë blerje të monedhave-kriptovalutave, të cilat më pas i ka shitur dhe i ka shndërruar në para/euro, çka me këtë ka përfutur një shumë në vlerë prej mbi 5,000.00 €.

11.) Diskutohet për përmirësimin e llogaridhënies në sistemin prokurorial, Kodit të Etikës si dhe Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë e Prokurorë

Prishtinë, 18 maj 2022- Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, ka pritur në takim përfaqësues të Projektit EUKOJUST, Johannes Van Vreesëijk dhe Bardha Maxhuni. Me këtë rast, Kryeprokurori Munishi, ka prezantuar sfidat në menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si prokuroria më e madhe në vend, si dhe funksionimin e aktivitetet e kësaj prokurorie. Takimi kishte për qëllim përmirësimin e llogaridhënies në sistemin prokurorial, po ashtu, përmirësimin në drejtim të aplikimi të Kodit të Etikës dhe Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë e Prokurorë.

12.) Mbahen ligjëratat me prokurorë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe përfaqësues nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronatike dhe Hekurudhore

Prishtinë, 25 maj 2022- Sipas iniciativës dhe nën organizimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, përgjatë ditëve 23, 24 dhe 25 maj 2022, janë realizuar takime në formë të ligjëratës për prokurorët e Departamentit të Krimeve të Rënda, Departamentit të

Përgjithshëm dhe për të Mitur, me pjesëmarrje të Kryetarit të KHAA (Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronatike dhe Hekurudhore), Mirsim Beqiri, si dhe Udhëheqësit të Departamentit për Hekurudhat, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Martin Halilaj.

13.) NJOFTIM PËR MEDIA

Prishtinë, 26 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik lidhur me rastin ku i dëmtuar është pronari i barnatores "Rexall", në Prishtinë, D.A., i cili para disa ditësh është sulmuar nga disa persona me mjete të forta, ashtu që, prokurori kujdestar, ka autorizuar policinë në ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore lidhur me këtë rast, derisa më 24 maj 2022, me urdhër të prokurorit është iniciuar rast në drejtim të veprës penale "Kanosja", nga neni 181 të KPRK-së, ku i dëmtuar në këtë rast është A.A., (vëllai i të dëmtuarit të lartcekur) dhe me aktvendim mbi ndalim janë ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh të dyshuarit B.M. dhe A.S., si dhe ndaj të njëjtëve, më 25.05.2022, Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente, në drejtim të veprës penale "Kanosja", të paraparë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

14.) Kërkohej paraburgim ndaj dy personave për lëndim të rëndë trupor ndaj pronarit të një barnatoresje në Prishtinë

Prishtinë, 28 maj 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente, ndaj të pandehurve V.C. dhe A.C., në drejtim të veprës penale "Lëndimi i rëndë trupor", nga neni 186 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se më 22 maj 2022, rreth orës 02:20, para barnatores "Rexall", në rrugën "Mark Dizdari", në Prishtinë, derisa i dëmtuari D.A., ka qenë duke e mbyllur barnatoren e lartcekur, të pandehurit V.C. dhe A.C., me dashje dhe në bashkëkryerje e kanë sulmuar me mjete të forta (shufra) të dëmtuarin, me të cilat veprime i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore.

15.) Vazhdon aksioni vullnetar i dhurimit të gjakut në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 10 qershor 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut organizuan një aksion vullnetar për dhurim të gjakut, me ç' rast janë duke iu përgjigjur ftesës për dhurim punonjësit e kësaj prokurorie.

Bashkëpunimi ndërinstytucional ka vazhduar përmes aksioneve të tilla, i fundit në këtë institucion ishte ai i datës 14 janar 2022 për të vazhduar edhe sot, përmes akteve të tilla humanitare që shpëtojnë jetë njerëzish.

Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzion të Gjakut ka vlerësuar lart iniciativën e dhurimit të gjakut, duke shprehur mirënjohje për të gjithë dhuruesit vullnetarë të gjakut, si dhe nga ky aksion vullnetar, të dy institucionet shprehën interesim të dyanshëm për të bërë akte të tilla humanitare në vazhdimësi.

16.) Kërkohej paraburgim ndaj dy zyrtarëve policor për keqtrajtje gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike dhe lëndim të lehtë trupor

Prishtinë, 17 qershor 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën

kompetente, ndaj të pandehurve V.M. dhe A.D., në drejtim të veprave penale "Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike" dhe "Lëndimi i lehtë trupor", nga neni 195 dhe 185 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se më 15 qershor 2022, rreth orës 22:40, në Stacionin Policor në Fushë Kosovë, të pandehurit, në cilësinë e zyrtarëve policor, në bashkëkryerje e kanë keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht një person (të dëmtuarin), në atë mënyrë që përderisa të pandehurit e kishin ndalur të dëmtuarin në qytetin e Fushë Kosovës për shkak të një kundërvajtje në trafik, të njëjtit i kishin marrë dokumentet dhe i kishin kërkuar që të vinte në stacionin policor, ashtu që, pasi kishte arritur në stacion, të dëmtuarin e kishin vendosur në një zyre dhe gjatë përpilimit të fletë-kundërvajtës, të pandehurit fillimisht e kishin fyer e pastaj të njëjtin edhe e kanë sulmuar fizikisht.

17.) Ndalohet me urdhër të Prokurorit të Shtetit edhe një person për rastin e mashtrimit të qindra qytetarëve dhe kërkohet paraburgim ndaj të njëjtit

Prishtinë, 24 qershor 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, konkretisht Departamenti i Përgjithshëm, ju njofton se si vazhdimësi e ndërmarrjes së veprimeve hetimore nga ana e prokurores së çështjes, lidhur me rastin e mashtrimit të qindra qytetarëve, në të cilin kanë përfunduar të arrestuar më parë katër (4) persona, më 23 qershor 2022, është ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh, personi me inicialet V.C., për shkak të dyshimit se ka kryer veprat penale "Mashtrimi" dhe "Falsifikimi i dokumenteve", të parapara sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe ndaj të njëjtit, prokurorja e rastit ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri V.C., nga data 12.09.2019 e deri në muajin shtator 2021, në Agjencinë "BCD Travel", për të cilin rast prokurorja e ka njoftuar opinionin publik, i njëjti në bashkëkryerje me disa persona kanë mashtruar qindra qytetarë, tani të dëmtuarit, në atë mënyrë që duke përdorur dokumente të falsifikuara kanë hapur agjencinë e lartcekur dhe përmes paraqitjes së rreme të fakteve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore kanë mashtruar të dëmtuarit kinse për t'ju siguruar viza pune për në shtetet perëndimore dhe skandinave, për të cilat shërbime të aplikimit përmes kontratave të pavërteta, të dëmtuarit kanë paguar shumën të caktuar të parave me premtimin se do t'i marrin vizat, mirëpo pas përpjekjeve për të kontaktuar me personat përgjegjës, të pandehurit nuk janë lajmëruar, me ç' rast të dëmtuarve ju është shkaktuar dëm material.

18.) Aktakuzë kundër dy zyrtarëve policor për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike dhe lëndim të lehtë trupor

Prishtinë, 30 qershor 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Prokurori i Shtetit, pas zhvillimit të hetimeve, mbledhjes dhe analizimit të provave, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve V.M., dhe A.A., në drejtim të veprave penale "Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike" nga neni 195, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprën penale "Lëndimi i lehtë trupor" nga neni 185, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, më 15 qershor 2022, rreth orës 22:40, në Stacionin policor të Fushë Kosovës, të pandehurit, në cilësinë e zyrtarëve policor, në bashkëkryerje, e kanë keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht të dëmtuarin L.H., në atë mënyrë që, përderisa të pandehurit e kishin ndalur të dëmtuarin në qytetin e Fushë Kosovës për shkak të një kundërvajtje në trafik, të njëjtit i kishin marrë dokumentet dhe i kishin kërkuar që të paraqitej në stacionin policor, i cili pasi kishte arritur në stacion, të njëjtin e kishin vendosur në një zyre dhe gjatë përpilimit të fletë-kundërvajtës, të pandehurit fillimisht e kishin fyer dhe cenuar dinjitetin e pastaj të njëjtin edhe e kanë sulmuar fizikisht, duke e goditur me grushte në fytyrë e më pas me shkelma e grushte në pjesë të ndryshme të trupit.

	<p>Sa i përket informimit të opinionit publik përmes komunikatave, për rastet me interes, këtë tremujor vërehet një numër më i madh i tyre, krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti, mirëpo gjatë kësaj periudhe publiku është informuar edhe përmes prononcimeve me shkrim dhe atyre me kamerë.</p> <p>*Vërehet përmirësim në komunikimin e brendshëm, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të mirëfilltë.</p> <p>Po ashtu, vërehet interesim më i madh i gazetarëve për ta konfirmuar informatën nga institucioni ynë para publikimit të saj, çka ndikon pozitivisht në informimin e saktë të opinionit publik, si dhe ngritjes së besueshmërisë në institucionin e Prokurorit të Shtetit.</p>
3	<p>Objekti 3: Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale.</p> <p>Komento:</p> <p>Në prokurori kemi krijuar një data-bazë e cila përmban në mënyrë të detajuar të gjitha rastet penale që kanë të përfshirë edhe procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit. Kemi caktuar dy koordinatorë nga dy Departamentet në DKR dhe DP të cilët kanë të angazhuar nga një bashkëpunëtorë profesional, të cilët bëjnë përditësimin e vazhdueshëm të këtyre rasteve që nga hapi i parë e deri në fazat përfundimtare.</p> <p>Lidhur me punën e prokurorisë kemi një komunikim direkt me zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit përkatësisht me koordinatorin kombëtar dhe të njëjtit i raportojmë në mënyrë periodike lidhur me procedurat e sekuestrimit/konfiskimit.</p> <p>Për këtë periudhë janë paraqitur në DKR 11 kërkesa për sekuestrim, ndërsa në DP kemi pranuar gjithsej 5 kërkesa.</p>
4	<p>Objektivi 4: Zvogëlimi i numrit të lëndëve në Prokurorinë e Shtetit.</p> <p>Komento:</p> <p>Prokuroria Themelore në Prishtinë, mbështetur në të dhënat e gjeneruara, për periudhën Prill-Qershor 2022, paraqet të dhënat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë të bartura nga muaji mars 2022 janë 47.661 lëndë; - Lëndë të pranuar gjatë periudhës Prill-Qershor 2022 janë 4.655 lëndë ; - Lëndë të zgjidhura në këtë periudhë janë 2.616 lëndë; - Lëndë të papërfunduara në fund të periudhës Qershor 2022 janë 49.697 lëndë; <p>Kryeprokurori vazhdimisht ka kërkuar nga prokurorët që për lëndët e ndërlikuara të kërkojnë që lënda e tyre të punohet në grup punues, në mënyrë që të merret barra e përgjegjësisë nga një grup i prokurorëve dhe veprimet hetimore të përfundohen me kohë.</p> <p>Prokuroria Themelore në Prishtinë ka të krijuara njësitë të specializuara brenda strukturës së saj, në të cilat janë të angazhuar prokurorë të profilizuar në trajtimin e rasteve me natyrë më specifike siç janë krimet ekonomike, korrupsioni si dhe rastet e dhunës në familje. Kjo formë e organizimit bën që rastet e tilla të përfundohen më shpejtë dhe iu jepet rëndësia maksimale.</p>

	<p>Po ashtu, Prokuroria Themelore në Prishtinë i ka dhënë prioritet aplikimit të procedurave alternative për ato raste penale kur plotësohen kushtet e përcaktuara me ligj, kjo ka rezultuar që edhe numri i lëndëve aktive të zvogëlohet.</p>
5	<p>Objektivi 5: Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i vazhdimësisë së punës në pandemi. Komento:</p> <p>Në këtë periudhë kemi punuar me kapacitet të plotë, marrë parasysh që më nuk ka pasur plane të reduktimeve si pasojë e pandemisë</p>
6	<p>Objektivi 6: Administrimi efikas, llogaridhënia dhe rritja e profesionalizimit: Komento:</p> <p>Është thelluar bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ashtu që përmes takimeve të rregullta kemi përmirësuar dukshëm bashkëpunimin dhe kemi arritur në ngritjen e profesionalizimit dhe mënjanimit të pengesave.</p> <p>Më tutje përmes komunikatave vazhdimisht kemi njoftuar publikun për trajtimin e rasteve brenda Kompetencave të lejuara për dhënie të informatave në çdo fazë të procedurës penale konform dispozitave ligjore.</p> <p>Vazhdimisht është kërkuar nga prokurorët raporte javore , mujore, tremujore gjashtëmujore, duke përfshirë njoftime lidhur me trajtimin e lëndëve, duke kërkuar që në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë përpilimin e shkresave, vendimeve e ankesave të dërguara si në gjykatë ashtu edhe në Institucione të tjera.</p> <p>Për këtë periudhë përmes Udhëheqësve të departamenteve nga prokurorët kemi kërkuar raporte lidhur me prioritetet në lëndë në baza tre mujore, dhe atë :</p> <p><i>Rezultatet për tre (3) mujorin e dytë të vitit 2022 (Prill, Maj, Qershor);</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Ø Caktimin e rasteve të cilat ata i vlerësojnë se janë me prioritet;</i> <i>Ø Kronologjinë e rasteve me prioritet;</i> <i>Ø Rastet për të cilat prokurorët kanë marrë aktvendim për fillim të hetimeve ose për të cilat do të marrin aktvendim për fillim të hetimeve;</i> <i>Ø Objektivat për 3 mujorin e ardhshëm;</i>
7	<p>Objektivi 7: Aplikimi më efikas i procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve penale. Komento:</p> <p>Duke parë rëndësinë e aplikimit të procedurës alternative të negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, vazhdimisht jemi përkushtuar që në lëndët që plotësohen kushtet të aplikojmë përdorimin e kësaj procedure. Po ashtu, kemi filtruar përsëri me kujdes secilën kërkesë për negociim të marrëveshjes për pranim të fajësisë në mënyrë që të rritet kualiteti i këtyre rasteve.</p> <p>Për PTH në Prishtinë, ndërmjetësimi edhe më tej mbetet një alternativë shtesë e rëndësishme e cila po mundëson zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve, jep rezultate më të shpejta, ka kosto më të ulët dhe fleksibilitet më të madh dhe ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve.</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, është arritur gjithsej një (2) marrëveshje për pranim të fajësisë:</p> <p>Ndërmjetësimi:</p>

	<p>Për periudhën Prill-Qershor 2022, në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prokurorinë Themelore Prishtinë janë referuar 112 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 103 lëndë, me 271 persona.</p>
8	<p>Objektivi 8: Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i Prokurorit të Shtetit: Komento: Gjatë periudhës raportuese, Kryeprokurori dhe prokurorët kanë pasur bashkëpunim të ngushtë me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare.</p> <p><u>Procedurat e zhvilluara me Ndihmë Juridike Ndërkombëtare</u></p> <p>Edhe në këtë periudhë kujdes të veçantë i është kushtuar rasteve me kërkesa ndërkombëtare, duke ndarë si përgjegjësi shtesë për zyrën e kryeprokurorit që çdo kërkesë e natyrës urgjente dhe të tjera t'u ndihmojë prokurorëve, të njëjtat t'i vë në pah që të trajtohen sa më shpejtë, duke ofruar ndihmë profesionale. Prokuroria Themelore Prishtinë ka të caktuar dy (2) koordinator për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë. Përmes këtij përkushtimi si prokurori kemi pranuar vlerësime pozitive edhe nga Institucionet e tjera.</p> <p>Në këtë periudhë kemi pranuar gjithsej <u>20 kërkesa</u> për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë të cilat jemi munduar ti përfundojmë në afate sa më të shpejta dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1- Kërkesa kane qenë marrje në pyetje të pandehurve 7- Kërkesa me arrestim të përkohshëm 11- Shkëmbimi i informatave me Prokuroritë /Gjykatat e shteteve të huaja 1-Kerkes për transferimin e procedurës penale nga Kosova në Shtetin e huaj <p>Ne këtë periudhe raportuese janë trajtuar dhe zgjidhur 30 lende kërkesa prej tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> 3 Kërkesa kane qenë marrje në pyetje të dëshmitareve 6 Kërkesa kane qenë marrje në pyetje të pandehurve 4 Kërkesa kane qenë marrje në pyetje të eksperteve 17 Shkëmbimi i informatave me Prokuroritë /Gjykatat e shteteve të huaja

IV. KËRKESAT SPECIFIKE TË KPK-së, (për periudhën e konkrete të shenjëzuar të raportimit)

1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	

V. ASPEKTE ADMINISTRATIVE:

Raportimi	Periudha kohore për të cilën raportohet	Shenjëzimi
I parë:	Nga 1 janar deri më 31 mars të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I dytë:	Nga 1 prill deri më 30 qershor të çdo viti	<input checked="" type="checkbox"/>
I tretë:	Nga 1 korrik deri më 30 shtator të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I katërt:	Nga 1 tetor deri më 31 dhjetor të çdo viti	<input type="checkbox"/>

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kërkuar nga Kryeprokurori që të dorëzoj raportin:	Kryeprokurori e ka dorëzuar raportin në Këshill (para raportimit):
Me datë: _____	Me datë: <u>29.07.2022</u>



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE Prishtinë
OSNOVNO TUŽILAŠTVO

DEPARTAMENTI Djega e Kryeprokurorit
DEPARTMAN

Sherja e kërkesës _____
Oznaka zahteva _____

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL - DOSTAVNICA ZA LIČNO URUČENJE

Të paturavejshme, bjeru rize - Nepotrebni čas pravnika

Marrësi: E. Fetah Maloku

Primalac: _____

1. Pasi marrësi nuk u gjet në vendin ku duhej të dorëzohej shkresa, dorëzimi u bë duke iu dhënë shkresa anëtarëve madhor të familjes së marrësit, kujdestarit të ndërtesës, (qiu, personit që gjendet i inkadruar në punë në të njëjtin vend.

2. Pasi marrësi ose pjesëti i familjes së tij e ka refuzuar marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë, në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

1. Posto primalac nije naden na mestu gde je trebao spis da se uruduje, spis je dostavljen punoletnim članovima porodice primaoca - starijemu zgrade, komšiji, licu koji se nalazi na istom radnom mestu

2. Posto je primalac ili član njegove porodice odbio primanje spisa, spis mu je ostavljen u stanu, radnom mestu primaoca (postavljajući to na vrata stana ili lokala gde se primalac poslom nalazi.

Ime _____ në ora _____
Dana _____ u časova _____

Shkaku i refuzimit _____
Razlog odbijanja _____

Nënshkrimi i dorzësuesit - Potpis dostavljača _____

Titulli i shkresës që dorëzohet :
Naziv spisa koji se dostavlja:

Mehanizmi i raportimit

Numri i shtojcave: _____
Broj priloga : _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)
Potvrđujem da sam uzeo gorenavedeni spis (rečima)

Nënshkrimi i marrësit - Potpis primaoca

01.08.2022 [Signature]

Nënshkrimi i dorzësuesit - Potpis dostavljača _____

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruaj, nënshkruan dërguesi duke shënuar shkaku për marrësi nuk e vuri nënshkrimin e vet.

U slučaju da je primalac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač s napomenom zašto primalac nije stavio svoj potpis.